



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 176/3 Prot.

Tiranë, më 2/15/2013

REKOMANDIM

Nr. 04 datë 2/15/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor" (ISKSH) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhërit nr. 56, datë 11/03/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor" (ISKSH) Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Objekti i kontrollit administrativ ishte:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në sistemet online (eFarmaci dhe Regjistri elektronik i banorëve) si dhe (Regjistrin të dhënësve privat të shërbimit) nga kontrolluesi "ISKSH", bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, në lidhje me:

- Qëllimin, Proporcionalitetin dhe Përshtatshmërinë;
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27);
- Ruajtja e konfidencialitetit (neni 28);
- Veprimtaritë e përpunuesve në lidhje me procesin;

Grupi i kontrollit administrativ:

- U njoh dhe shqyrtoi dokumentacionin e kontrolluesit.
- Intervistoi dhe mori deklaratime nga përfaqësues të kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e kontrolluesit.
- Administroi me cilësinë e provës në funksion të kontrollit administrativ, dokumente shkresore lidhur me funksionimin e sistemeve "eFarmaci", "regjistri elektronik i banorëve" dhe "regjistrin të dhënësve privat të shërbimit".

Gjatë kontrollit administrativ janë krijuar kushte për ushtrimin e tij, përfaqësuesit e kontrolluesit u treguan bashkëpunues në të gjitha fazat e ushtrimit të kontrollit administrativ, si dhe vendosen në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentet shkresore të kërkuara.

1. Kontrolluesi ka marrë masat e duhura për sigurinë e të dhënave personale duke hartuar udhëzime, rregullore për procedurat që realizohen në programin “eFarmaci” duke kërkuar respektimin e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Procedurat, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, aksesit, etj janë të sakta dhe krijojnë siguri në përpunimin e të dhënave personale nga ky kontrollues.

Kontrolluesi lidh kontratë me të gjitha farmacitë dhe depot e farmacive sipas modelit tip të aprovuar nga ai, kjo kontratë ka si referenca ligjore ligjet në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Në këtë kontratë konstatohet që nuk janë bërë referenca ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale nga ana e subjekteve kontraktuese (ISKSH –farmacitë, depot) të parashikuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se përveç masave të marra duhet që kontrolluesi ISKSH, të parashikojë në kontratë rregulla të detyrueshme për palët për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale që ato mblidhin dhe përpunojnë. Këto rregulla janë shumë të rëndësishme të vendosen për faktin se mblidhen të dhëna personale të shtetasve duke përfshirë dhe të dhëna sensitive lidhur me shëndetin (sëmundjet e ndryshme që ata kanë). Të dhënat personale duhet të përpunohen duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta këto të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për “Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut” dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

2. Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (neni 2/6) kontrolluesi krijon “Regjistrin e Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore”, në të cilin regjistrohen dhënësit e shërbimeve publik, si dhe ato privat. Kontrolluesi nuk ka filluar të plotësojë këtë regjistër dhe është në fazën e përgatitjes të udhëzimeve dhe procedurave lidhur me këtë regjistër on-line të dhënësve të shërbimeve shëndetësore.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se tani është momenti i duhur që kontrolluesit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të përfshirë në udhëzimet, rregullat dhe procedurat, lidhur me “Regjistrin e dhënësve privat të shërbimit” kërkesat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar për të mbrojtur të dhënat personale që mblidhen, përpunohen dhe ruhen gjatë plotësimit të këtij regjistri.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar :
 - Në kontratën tip që lidhet me të gjitha farmacitë dhe depot e farmacive të parashikohen rregulla të detyrueshme për palët për mbrojtjen e të dhënave

personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale që ato mbledhin dhe përpunojnë;

- Të merren të gjitha masat e nevojshme për të përfshirë në udhëzimet, rregullat dhe procedurat lidhur me *"Regjistrin e dhënësve privat të shërbimit"*, mbrojtjen e të dhënave personale si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale që mblidhen, përpunohen dhe ruhen gjatë plotësimit të këtij regjistri.
2. Për hartimin e këtyre akteve Autoriteti i Komisionerit ofron asistencën e tij;
 3. Ky detyrim i rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh;
 4. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 5. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, sipas të cilit... *"Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave"*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

